



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
TË LËNA NË VITIN 2021Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

(Auditim Tematik)

**“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021, në
Agjencinë Kombëtare të Bregdetit”**

Maj 2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

PËRMBAJTJA			
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1.Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
		2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	
		3.Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	
II.	Hyrja	1. Objektivi i Auditimit	3-5
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e vlerësimit	
		7. Standardet e auditimit	
		8. Metodatat e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III	Përshkrimi i auditimit	5-21	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	5	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	5	
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, òPër Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.	5-6	
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	7	
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	7-17	
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	17-19	
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	19-20	
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	20-21	
IV	Gjetje dhe rekomandime	21	
V	Lista e dokumenteve të auditimit	21	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i raportit të auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim tematik në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, përcjellë me shkresën nr. 20/10, prot, datë 29.07.202. Kjo shkresë është protokolluar në AKB me 18/22 prot, datë 02.08.2021. Grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 01.10.2021 ëMbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2021ë. Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-konstatim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

I.2. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Nga 54 masa të rekomanduara, 26 masa ose 48.1% janë zbatuar, 21 masa ose 38.8% janë në proces zbatimi, 4 masa ose 7.4 % nuk janë zbatuar ndërsa 3 masa ose 5.7 % janë zbatuar pjesërisht. Sipas natyrës së masave të rekomanduara, statusi i zbatimit paraqitet si vijon:

- Për përmirësimin e gjendjes nga 33 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 17 rekomandime, 16 rekomandime janë në proces zbatimi;
- Për masa shpërbllim dëmi janë lënë 4 rekomandime në vlerën 1.284 mijë lekë nga të cilat 1 masë është zbatuar, duke arkëtuar vlerën 21,365 lekë ndërsa 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht;
- Për masat 3E, janë rekomanduar 2 masa të cilat janë në proces;
- Për 11 masa disiplinore, janë zbatuar 7 masa, 4 masa nuk janë zbatuar nga të cilat 3 janë ezauruar.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Bregdetit ëMbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021ë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 162/4 datë 14.02.2022, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. A.M, Përgjegjës Grupi
2. L.K, auditues
3. O.L, auditues
4. R.A, auditues

Titulli

Raport Përfundimtar Auditimi mbi verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2021 të kryer në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Marrësi

Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Titullari i institucionit është L.L, Drejtor.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Ky auditim ka objektiv pasqyrimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të kryer pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësive publike. Gjithashtu ka si qëllim raportimin mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

Identifikimi i çështjes



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Æ NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

Veprimtaria e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, bazohet në ligjin nr. 93/2015 datë 17.12.2015 ÆPër Turizmin, i ndryshuar dhe VKM nr. 31, datë 22.01.2014, e ndryshuar me VKM nr. 569, datë 17.07.2019. Grupi i auditimit ka vlerësuar me risk të ulët deri të mesëm, të dhënat lidhur me zërat që zënë peshën kryesore të buxhetit, si dhe pikat e tjera. Për këtë jemi mbështetur në hartimit e pyetësorëve të ndryshëm, si dhe kryer testime mbi transaksionet financiare, në kombinimin e intervistave, rishikimeve analitike të dokumenteve për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e veprimeve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së subjektit të audituar.

Grupi i auditimit ka shtrirë auditimin sipas çështjeve kryesore, ku shtrihet aktiviteti i institucionit:

-Mbi masat e marra në mbështetje të hartimit të politikave, strategjive për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare, programet e hartuara dhe zbatuara dhe bashkërendimi e bashkëpunimi me institucionet e organet e tjera.

-Mbi procedurat e ndjekura për dhënien në përdorim dhe administrimi i plazheve si nga subjektet vendore shtetërore dhe private, administrimi i plazheve publike dhe roli i AKB në funksion të monitorimit.

-Mbi monitorimin dhe respektimin e kriterëve ligjore për kryerjen e veprimtarive turistike nga subjektet e kontraktuara në zonën bregdetare (plazhe dhe vende të tjera të përdorura për aktivitetet turistik, etj.) për v. 2020 dhe ne raste identifikimi risku në periudhën e mëparshme 2016-2019.

-Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

-Mbi administrimin e shpenzimeve dhe përdorimi i fondeve me destinacion përballimi i fatkeqësive natyrore nga tërmeti dhe pandemia COVID -19 dhe dokumentacioni përkatës për v.2019 dhe v.2020.

-Mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e kryerjes së veprimeve me bankën.

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe pagave. Mbi administrimin e pronës shtetërore, për v. 2020 dhe ne raste identifikimi risku në periudhën e mëparshme 2016-2019.

-Mbi respektimin e strukturave organike të miratuara, dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, dhe respektimi i fondeve të planifikuara me destinacion shpenzimet e pagave të punonjësve, për v. 2020 dhe ne raste identifikimi risku në periudhën e mëparshme 2016-2019.

-Mbi prokurimin e fondeve publike.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Strukturat drejtuese të subjektit Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB), mbajnë përgjegjësi për shkeljet dhe problematikat e konstatuara sipas çështjeve nën auditim, në lidhje me shpenzimet e fondeve publike, dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për promovimin dhe monitorimin e projekteve, ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare e të planeve të miratuara nga autoritetet e planifikimit, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 93/2015, datë 13.12.2015 ÆPër Turizmin, i ndryshuar dhe VKM nr. 31, datë 22.01.2014, i ndryshuar, me VKM nr. 569, datë 17.07.2019.

Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÆPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe raporti përfundimtar i auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Metodat e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

Dokumentimi i rezultateve të Auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) ka statusin e drejtorisë së përgjithshme, me nivel qendror dhe në nivel vendor organizohet në 4 degë rajonale. AKB drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili drejton dhe organizon të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit për turizmin.

AKB-ja ka objekt të veprimtarisë së saj dhe kryen këto funksione:

- Mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare;
- Zbatimin e politikave e të strategjive për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- Bashkërendimin e programeve të lidhura me zonën bregdetare;
- Dhënien e kontributit në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e të strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- Marrjen pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre;
- Bashkëpunimin me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- Monitorimin e zbatimit me përpikëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore dhe vendore në zonën bregdetare, si dhe monitorimin e respektimit të kriterëve për dhënien në përdorim dhe administrimin e plazheve, bazuar në kontratat përkatëse të lidhura ndërmjet subjekteve private dhe pushtetit vendor;
- Monitorimin e respektimit të kriterëve ligjore për kryerjen e veprimtarive turistike detare, të cilat zhvillohen në zonën bregdetare.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi u konstatua se:

- Nga titullari i institucioni është nxjerrë Urdhër për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, por për zbatimin e tyre janë marrë masa nga specialistët e të gjithë sektorëve përkatës të prekur në Raportin Përfundimtar të KLSH, rast pas rasti sipas detyrave të gjithsecilit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

- Me shkresën nr. 1449, datë 20.08.2021 nga ana e AKB është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së Nr. 45, datë 16.08.2021 është ngritur dhe grupi i punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor është zbatuar.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 20/10 prot, datë 29.07.2021 janë lënë gjithsej

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes nga 33 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 17 rekomandime, 16 rekomandime janë në proces zbatimi.
- Për masa shpërblim dëmi janë lënë 4 rekomandime në vlerën 1.284 mijë lekë nga të cilat 1 masë është zbatuar, duke arkëtuar vlerën 21,365 lekë ndërsa 3 rekomandime janë zbatuar pjesërisht.
- Për masat 3E, janë rekomanduar 2 masa të cilat janë në proces.
- Për 11 masa disiplinore, janë zbatuar 7 masa, 4 masa nuk janë zbatuar nga të cilat 3 janë ezauruar.

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike								
		Rekomandim gjithsej	Nga janë:				Pjesërisht	Rekomanduar		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar	Gjithsej		Zbatuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)				Pa zbatuar	
								arkëtuar	Zbatuar pjesërisht	Nr. Per s	Në mijë/lek	Nr. per s	Në mijë/lek	Nr. per s	Në mijë/lek
					Nr. per	Në mijë/lek	Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Per s	Në mijë/lek	Nr. per s	Në mijë/lek			
1.	Masa organizative	33	17	16											
2.	Masa për përmirësim ligjor	3	1	2											
3.	Shpërblim dëmi	4	1			3		1,284		21					
4.	Masa 3E	2		2											
5.	Masa disiplinore	11	7		4										
6.	Masa administrative	1		1											
	Totali														



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

2.2 Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë iniciativën ligjore dhe t'ia propozojë KM ndryshimin (apo përmirësimin) e pikës 2 te nenit 4 te VKM nr. 171, date 27.03.2019, me qëllim për të vendosur një raport të drejtë mes plazhit publik dhe plazhit privat, ku ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik të bëhet proporcionalisht, në mënyrë perpendikulare me vijën bregdetare ,sipas një raporti të drejtë, ku gjithmonë të prevalojë interesi publik duke rritur aksesin e lirë të qytetarëve në plazhe, pa cenuar të drejtën e subjekteve private për zhvillimin e biznesit.

Komenti: Në proces. Rekomandimi është vlerësuar nga AKB, por miratimi i listës së plazheve dhe i hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, nuk miratohet nga AKB, por nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit turistik, bazuar në propozimet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, sipas Vendimit nr. 171, datë 27.03.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar. Ndërkohë që do të sugjerohet mundësia për ta përfshirë në draft ligjin për bregdetin, sipas Urdhrit të Ministrit të Turizmit të Mjedisit Nr. 8654 prot, datë 01.12.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare”.

2.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë iniciativën ligjore dhe ti propozojë KM ndryshimin (apo përmirësimin) e VKM nr. 171, dt. 27.03.2019, me qëllim plotësimin e listës së plazheve me tipologjitë përkatëse A, B, AB e C dhe sidomos për plazhin e tipit C, ku nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi.

Koment: Në proces. Për këtë rekomandim do të sugjerohet mundësia për ta përfshirë në draft ligjin për bregdetin, sipas Urdhrit të Ministrit të Turizmit të Mjedisit Nr. 8654 prot, datë 01.12.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare”.

3.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë iniciativën ligjore dhe t'ia propozojë KM, hartimin e projekt-ligjit dhe dërgimin për miratim, duke rishikuar edhe një herë konformë legjislacionit shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, si Konventa e Barcelonës "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut, aderuar me ligjin nr. 10234/2010, ligjin nr. 111/2012 òPër Menaxhimin e Integruar të Ujërave ò i ndryshuar, Ligjin nr. 93/2015 òPër turizmin, etj. akte relevante në fjalë.

Koment: Rekomandimi është zbatuar, në zbatim të të cilit ka dalë dhe Urdhri i Ministrit të Turizmit të Mjedisit Nr. 8654 prot, datë 01.12.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare”.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që në përgatitjen e Rregullores së re të organizimit dhe funksionimit të brendshëm, të specifikojë në mënyrë të qartë dhe shteruese detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe strukturave përkatëse, të ketë implementim të plotë të ndryshimeve në ligjin e ri, në mënyrë që të ketë përshkrim të detyrave për secilën drejtori,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

duke integruar tek detyrat objektivat me Konventën e Barcelonës òPër mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheutò.

Koment: *Rekomandimi është zbatuar nga AKB. Të gjitha këto rekomandime janë reflektuar në rregulloren e re mbi organizimin dhe funksionimin e AKB-së dhe Agjencive Rajonale të Bregdetit, e cila është dërguar për miratim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën e AKB-së Nr. 382 prot, datë 21.06.2021, mendimet dhe rekomandimet e përcaktuara me shkresën Nr. 382/2, datë 30.09.2021.*

2.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të përditësojë rregulloret e plazheve sipas hartave të miratuara nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik dhe të diferencojë sipërfaqen e plazhit për përdorim publik nga sipërfaqja për përdorim privat nga stacionet e plazhit, përmes një linje të qartë demarkacioni.

Koment: *Në proces. Pasi me legjislacionin e ri do të parashikohen rregullore të detyrueshme.*

3.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të rakordojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës mbi situatën e zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar, si dhe t'ia kërkojë bashkive bregdetare statusin e regjistrimit të pasurive publike, përfshirë ato të transferuara, me qëllim krijimin e një inventari paraprak të bregdetit.

Koment: *Zbatuar. Në zbatim të urdhërit Nr. 57 datë 29.10.2020 "Për mbikëqyrjen e punës së Agjencive Rajonale të Bregdetit" dhe urdhrit Nr. 58 datë 30.10.2020 "Për krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtar të zonës bregdetare", Drejtoria e Performancës dhe Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare në AKB në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Bregdetit ka nisur punën për krijimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare. Inventarizimi i veprimtarive turistike të zonës bregdetare konsiston në plotësimin e dosjeve fizike (Foto të subjektit, dokument plotësues nëse ka), dosjes digjitale (Dosje me informacione të mbledhura të hedhur në hartë me pozicionin përkatës) dhe fletës së inventarizimit (sipas formatit të përcaktuar në Anëxin I) çka do të bëjë të mundur krijimin e një harte digjitale ku do të pasqyrohen subjektet që operojnë në fushën e turizmit.*

4.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për krijimin e një modeli të inspektimit në bazë risku, si dhe të hartojë formatet standarde mbi mënyrën e ndjekur për procedurën e inspektimit.

Komenti: *Zbatuar: AKB ka punuar mbi përgatitjen e analizës së riskut për inspektimet e vitit 2022. Përsa i përket kuadrit rregullator, AKB i nënshtrohet ligjit të posaçëm nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar dhe ligjit nr. 10433/2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke vepruar sipas procedurave të përcaktuara nga ky kuadër ligjor, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar.*

5.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për të krijuar një rregullore ose udhëzim mbi profilin turistik që duhet të ketë një stacion plazhi, si dhe të krijojë një bazë të dhënash mbi kategoritë e bizneseve që operojnë si stacione plazhi.

Komenti: *Zbatuar. Kjo është plotësuar edhe me bazën e re ligjore. Rekomandimi do të mbahet parasysh nga AKB dhe në raport me draft ligjin "Për menaxhimin e Integruar të vijës Bregdetare", në zbatim të Urdhrit të Ministrisë së Turizmit të Mjedisit Nr. 8654 prot, datë 01.12.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit "Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare". Ndërkohë evidentojmë përsëri se: nxjerrja e akteve të tilla nuk është në kompetencat e AKB-së, pasi mënyra e organizimit, funksionimit, kriterëve, standardeve dhe procedurave që duhet të ushtrojnë një stacion plazhi, janë të përcaktuara në Vendimin e*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar. AKB, disponon një databazë të plotë të subjekteve që operojnë në vijën bregdetare, si dhe kriteret dhe standardet e ofruara nga ana e tyre.

6.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me bashkitë, të marrë masa për krijimin e strategjive të menaxhimit bregdetar, me qëllim unifikimin e planeve vendore, në rastet kur bashkitë ndajnë të njëjtën tipologji bregdetare.

Koment: Në proces. Ky rekomandim do të mbahet parasysh nga AKB dhe nëpërmjet dhënies së mendimeve, referuar dhe eksperiencës apo informacioneve që disponojmë nga terreni, por krijimi i strategjive të tilla të menaxhimit bregdetar, nuk është në kompetencat e AKB-së, pasi pavarësisht vijës së njëjtë bregdetare të disa bashkive, zhvillimi dhe niveli ekonomik e social i tyre etj... është i ndryshëm, ndaj AKB po vijon punën për shtyrjen e procesit për miratimin e projektligjit “Për menaxhimin e Integruar në zonën bregdetare”, i cili ndër të tjera, synon harmonizimin me planin e përgjithshëm kombëtar, planin sektorial kombëtar të turizmit, si dhe me planin e integruar ndërsektorial për brezin bregdetar. Në lidhje me këtë projektligj, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Turizmit të Mjedisit Nr. 8654 prot, datë 01.12.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare”, është caktuar dhe muaji nëntor 2022 si afat për paraqitjen e projektligjit para Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të vijuar me procesin e mëtejshëm të miratimit.

7.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në vijimësi, për të rritur shkallën e bashkëpunimit me institucionet e tjera (përgjegjëse për menaxhimin e bregdetit) dhe për çdo rast të konstatuar me shkelje gjatë procesit të monitorimit, për të cilat AKB-ja nuk ka kompetencë për të vepruar, të kërkojë nga institucionet përkatëse kompetente, ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, deri në eliminimin e plotë të shkeljeve të konstatuara dhe vënien para përgjegjësisë të personave shkelës të ligjit.

Koment: Në proces. Monitorimi i të gjithë zonës bregdetare është bërë nga Degët rajonale Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë në bashkëpunim me Zyrën Qendrore, e cila ka përcjellë pranë institucioneve kompetente të gjitha problematikat e konstatuara. Secili subjekt dhe veprimtari turistike është monitoruar, pavarësisht stafit të reduktuar të AKB-së dhe për çdo subjekt është mbajtur dokumenti i monitorimit i detajuar me kriteret dhe standardet e ofruara nga ana e tyre që nga viti 2016. AKB, në përputhje me rekomandimin e KLSH, është gjithmonë bashkëpunuese me të gjitha strukturat institucionale që operojnë në zonën bregdetare, me dërgimin e të gjitha informacioneve nga konstatimet në zonën bregdetare me qëllim realizimin e ndërhyrjeve nga ana e tyre. Puna e AKB-së ka qenë mjaft efektive në përputhje me kompetencat e përcaktuara në VKM-n mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit, ndërsa secili nga institucionet kompetente duhet të marrë masat për zbatimin e detyrimeve që i ngarkohen me legjislacionin përkatës.

8.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me degët rajonale të marrë masa, që çdo degë rajonale të krijojë regjistra elektronikë, për t’i azhurnuar ato me të dhëna në vazhdimësi, për çdo monitorim që kryhet, duke ndikuar kështu, në rritjen e cilësisë dhe transparencës së punës së kryer, gjatë monitorimit në terren.

Koment: Zbatuar. Rekomandimi do të vijojë të mbahet parasysh nga AKB, por theksojmë përsëri se AKB disponon një databazë të plotë të subjekteve që operojnë në vijën bregdetare, si dhe kriteret dhe standardet e ofruara nga ana e tyre, të ndara sipas Agjencive Rajonale të AKB-së Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë, megjithatë rekomandimi do të zbatohet dhe nga Agjencitë Rajonale të Bregdetit, për të vijuar me mbajtjen e këtyre regjistrave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

9.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në vijimësi, për të rritur shkallën e bashkëpunimit me institucionet e tjera, përgjegjëse për ofrimin e standardeve në plazhet publike, veçanërisht pjesa e kritereve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastrukturën e plazhit publik, dhe për çdo rast të konstatuar me shkelje gjatë procesit të monitorimit, për të cilat AKB-ja nuk ka kompetencë për të vepruar, të kërkojë nga institucionet përkatëse kompetente, ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, deri në eliminimin e plotë të shkeljeve të konstatuara dhe vënien para përgjegjësive të personave shkelës të ligjit.

*Koment: **Zbatuar.** Rekomandimi do të vijojë të mbahet parasysh nga AKB, ndaj për vitin 2022, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, ka pësuar ndryshimet përkatëse, por dhe realizimit në kohë të procedurave i është dhënë rëndësia maksimale, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 39, nr. 748 prot, datë 27.01.2022 “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i cili përcakto afatin e aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit që në muajin Janar, periudha 27.01.2022-28.02.2022. Të gjitha njësive vendore përkatëse, i është sjellë në vëmendje marrja e masave për infrastrukturën në plazhet publike. AKB ka monitoruar vazhdimisht këto plazhe, duke kërkuar dhe ndërhyrjen e të gjitha institucioneve kompetente në rast të konstatimit të shkeljeve, sipas natyrës së problematikave. Ky rekomandim do të vijojë të ndiqet me përparësi nga AKB.*

10.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit Tiranë me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, të hartojnë projekt buxhete PB dhe PBA, duke zbatuar procedurat ligjore, në kohë, mbështetur në plan veprimet dhe dokumente të hartuara me parë, në parashikimin e numrit dhe të kostove të produkteve, pra të bëhet një planifikim real dhe jo i fryrë i buxheteve, në tërësi dhe sipas zërave dhe artikujve e nën artikujve, me qëllim realizimin e plotë të tyre dhe projekteve e objektivave të vendosura, në mënyrë që mos të krijohet një situatë kontradiktore ku nga njëra anë disponohen fonde të bollshme dhe nga ana tjetër realizimi faktik i buxhetit është më pak se gjysma e fondeve të alokuara.

*Koment: **Zbatuar.***

11.1. Rekomandim: Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit me strukturat përkatëse, njësia e financës të marrë masa të plota për kryerjen e shpenzimeve duke dokumentuar me dokumente autorizuese e vërtetuese në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, të Ministrisë së Financave.

*Koment: **Zbatuar.** Rekomandimi është marrë parasysh nga AKB, por ndërkohë theksojmë përsëri se Urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.*

12.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit Tiranë me strukturat përkatëse, Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, të marrë masa që gjatë kryerjes së proceseve të inventarizimit të krijohet Komisioni për vlerësimin për tu nxjerrë jashtë përdorimit, si dhe komisioni i asgjësimit të materialeve.

*Koment: **Zbatuar.** Lidhur me konstatimin e Grupit të auditimit për inventarizimin e pasurisë 2020, ju bëjmë me dije se e i gjithë dokumentacioni gjendet në dosjen e Inventarit të Institucionit të vitit 2020, vënë në dispozicion të grupit të auditimit. Procedura e inventarizimit është realizuar sipas Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Rregullores Nr. 146, datë 24.07.2019 “Për administrimin e aktiveve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së Nr. 90, datë 24.12.2020, në rolin e titullarit të institucionit është ngritur Komisioni për Inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të zyrës për vitin 2020. Fillimisht Komisioni i Inventarizimit i ngritur ka*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

bërë fiksimin e numrit rendor të fletëthirrjeve dhe fletëdaljeve gjatë vitit 2020 me procesverbal të firmosur nga anëtarët e komisionit dhe magazinieri i institucionit. Në datën 28.12.2020 është bërë inventarizimi fizik i pasurisë dhe është mbajtur procesverbal nga Komisioni i Inventarizimit. Bashkëngjitur procesverbalit është vendosur regjistri i aktiveve të qëndrueshme të inventarizuara i firmosur nga komisioni, magazinieri dhe përgjegjësi i financës. Me shkresën Nr. 1973/1 datë 29.12.2020, Komisioni i Inventarizimit ka dërguar raportin e inventarizimit, ku ka paraqitur edhe propozimet e tij për nxjerrje jashtë përdorimi të disa aktiveve.

13.1. Rekomandim: AKB Tiranë, sektori i financës:

a. Në mbylljen e bilancit 2021 të sistemojë disa llogari të bilancit 2019, pasi ato mbarten në vitin pasardhës, konkretisht:

- të azhurnojë në zëra analitik llogarinë 212 òNdërtesa rikonstruksioneò për 30,617,417 lekë,
- të kuadrojë llogarinë 215 òMjete transportiò, pasi nuk kuadron vlera kontabël 11,542,974 lekë me vlerën e inventarit fizik 22,001,855 lekë, për diferencën 10,458,881 lekë,
- të sistemojë llogarinë 681 òAmortizimiò i akumuluar i mjeteve kryesore, pasi nuk është pasqyruar në bilancin 2019.

- të sqarojë gjendjen dhe pozicionin e llogarive vjetore nëpërmjet relacionit të bilancit 2021.

b. Të kryej inventarizimit fizik të pasurisë për vitin ushtrimor, pasi nuk është kryer për vitin 2019

*Koment: **Në proces.** Ju bëjmë me dije se rekomandimi do të rivlerësohet nga AKB gjatë përgatitjes së bilancit për vitin 2021, ndërsa për vitin 2019 inventari i pasurisë është realizuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.*

14.1. Rekomandim: AKB, Sektori i Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe me DAP, të marrin masa për plotësimin e strukturave të miratuara me numrin e caktuar të punonjësve në përputhje me kriteret profesionale të vendeve të punës, me synim eliminimin e vendeve vakantë të punonjësve me status nëpunës civil dhe punonjësve të shërbimit mbështetës, sikundër pasqyruar në tabelën òPlotësimi i Strukturës dhe vakancat në AKB për v.2020ò.

*Koment: **Zbatuar.** Ky rekomandim do vijojë të mbahet parasysht nga AKB. Në zbatim të Urdhrit nr. 25, datë 03.02.2020 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, AKB ka përfunduar procesin e ristrukturimit të institucionit, me daljen dhe të organikës së re.*

15.1. Rekomandim: AKB Tiranë, bazuar në shkeljet e konstatuara në lidhje me pagesat e kryera për punësimin e 10 studenteve ekselence me kontratë të përkohshme për strukturën e miratuar për vitin 2020, kryer pagesa të tepërta si diferencë ndërmjet kategorive në vlerën 11000 lekë, të marrë masa për përcaktimin e detyrimeve dhe arkëtimin e tyre, duke kërkuar më parë nga DAP, Ministria e Linjës, Ministria e Financave, interpretimin e pikave 4-5 të VKM nr. 16, datë 16.01.2019, dhe të pikës 5, të VKM nr. 47, datë 22.01.2020, për strukturën e miratuar për vitin 2020, që sipas së cilës punonjësit me kontratë në funksion specialist paguhen në përputhje me kategorinë e pagës së funksionit të ngjashëm organik.

*Koment: Rekomandimi **është zbatuar** nga AKB. Në zbatim të VKM-së nr.766, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në Institucionet e Administratës Shtetërore, pjesë të Shërbimit Civil, për vitin 2019”, si dhe shkresës së ardhur nga Departamenti i Administratës Publike nr.1465/8 prot, datë 06.03.2019, me lëndë “Mbi përzgjedhjen e të sapodiplomuarve student të ekselencës në institucionin tuaj”, protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit nr.128 prot, datë 08.03.2019, janë punësuar 6 (gjashtë) specialist. Në raundin e dytë, në zbatim të VKM-së nr.586, datë 30.08.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, si dhe shkresës së ardhur nga Departamenti i*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

Administratës Publike nr.6547/36 prot, datë 04.11.2019 me lëndë “Mbi përzgjedhjen e të sapodiplomuarve student të ekselencës në institucionin tuaj”, protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit me nr.650 prot, datë 05.11.2019, janë punësuar 4 (katër) specialist. Në të dyja raundet e punësimit të studentëve të ekselencës, të cilët në total janë 10 (dhjetë), kategoria e pagës është përcaktuar nga Departamenti i Administratës Publike pasi pozicionet e punës janë brenda strukturës, pjesë të shërbimit civil. Me shkresën nr 353 Prot, datë 23.06.2020, me lëndë “Kërkesë për interpretim”, AKB i është drejtuar DAP-it, për të sqaruar kategorinë e pagës për “studentët ekselentë”, të punësuar pranë AKB-së dhe është kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 2753/1, datë 01.07.2020, më lëndë “Kthim përgjigje tuajës nr.353, datë 23.06.2020”, protokolluar me tonën nr.353/2 prot, datë 02.07.2020, ku përcaktohet qartë që “studentët e ekselencës” janë të punësuar në pozicione pune pjesë të strukturave dhe organikave të institucioneve të administratës shtetërore dhe nuk përbëjnë shtesë të numrit të punonjësve apo pozicioneve të punës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Në përfundim DAP është shprehur se “studentët e ekselencës” të emëruar gjatë vitit 2019 në pozicione të strukturës dhe organikës së AKB-së, si pasojë e thirrjeve publike bazuar në VKM-në nr. 766/2018 dhe VKM-në nr.586/2019, paguhen me pagën mujore të pozicionit të punës në të cilin janë emëruar, të përcaktuar në VKM-në nr.187/2017, të ndryshuar dhe në Urdhërin e miratimit të strukturës dhe Organikës së AKB-së. Për 8 (tetë) specialistët me kontratë të përkohshme të cilët janë paguar me kategori page IV-a është marrë masa e ndryshimit të kategorisë së pagës sipas pikës 5, të VKM-së nr.47, datë 22.01.2020 “Për përcaktimin e numërit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, si rrjedhojë është ndjekur procedura e lidhjes së kontratave të reja, ndryshimi i kategorisë së pagës të cilët janë paguar nga IV-a në IV-b, si dhe janë lidhur marrëveshje me secilin nga punonjësit (në total 8) për kthimin e diferencës së shumës së përfituar nga kategori page IV-a në IV-b.

16.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa lidhur me menaxhimin e personelit, të analizojë pranim largimet e të punësuarve duke nxjerre shkaqet dhe faktorët negativ që kanë sjellë koeficientin e lartë të ndërprerjeve të marrëdhënies së punës me pasoja negative, si dhe të hartojnë e zbatojnë programe trajnimi e specializimi nën asistencën e eksperiencave brenda e jashtë vendit.

*Koment: **Proces.** Ky është një rekomandim që duhet parë rast pas rasti se cilit punonjës i referohet dhe jo i marrë në përgjithësi.*

17.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, AKB të marrë masa dhe të ndjekë me rigorozitet kryerjen e të gjithë procedurave në prokurimin e fondeve publike, veçanërisht lidhur me kriteret që rregullojnë procedurat e prokurimit, për konfiskimin e sigurimit të ofertës, s`kualifikimet e pjesëmarrësve në prokurime për deviacione të vogla, mosargumentim i fondit limit, etj.

*Koment: **Proces.** Rekomandimi do të mbahet parasysh nga AKB, ndërkohë që theksojmë përsëri se nga ana e AKB janë ndjekur të gjitha hapat sipas ligjit Për prokurimin public, udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe të gjitha procedurat janë realizuar me mjetet e prokurimit elektronik. AKB në të gjitha komentet e shpjegimet e saj ka argumentuar secilin vendim, shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues, i cili gjëndet në dosjet e prokurimit dhe i është vënë në dispozicion i plotë grupit të punës të KLSH.*

18.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, AKB, të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, për hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim të argumentuara dhe në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit, të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

*Koment: **Proces.** Rekomandimi do të mbahet parasysh nga AKB, nëse do të kemi prokurime të kësaj natyre, ndërkohë që theksojmë përsëri se ky rekomandim është plotësuar nga AKB dhe është respektuar me përgjegjësi të plotë në çdo procedurë prokurimi, duke u mbështetur vetëm në kuadrin ligjor në fuqi.*

19.1. Rekomandim: Nga AKB, për përmirësimin e punës në të ardhmen të merren masa që të plotësohen dosjet me të gjitha dokumentet e munguara si edhe kopje të mesazhit elektronik ose njoftimi zyrtar për shoqërinë e s'kualifikuar. Të kryhet hartimi i raporteve dhe të gjithë dokumentacionin përkatës të prokurimeve. Të bëhet llogaritja/rillogaritja e fondit limit duke qenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve përkatëse. Të përcaktohet e saktë baza ligjore e urdhrave të prokurimit. Dokumentacioni i operatorëve ekonomikë të jetë i plotë dhe i saktë në dosjen përkatëse. Të përgatiten dhe miratohen rregullorja funksionale dhe regjistri i riskut për këtë sektor.

*Koment: **Zbatuar.** Rekomandimi do të mbahet parasysh nga AKB, ndërkohë që theksojmë përsëri se: Nga ana e grupit të auditimit gjatë procesit të auditit janë shqyrtuar vetëm dosjet e Financës dhe jo dosjet e mbajtura nga Komisioni i Prokurimit të Blerjeve me Vlerë të Vogël. Në dosjet e financës gjëndet dokumentacioni i limituar, duke përfshirë dokumentat e kërkuara për efekt pagese sipas legjislacionit. Ndërsa dosja e detajuar, me të gjithë dokumentacionin provues sipas legjislacionit për prokurimin publik dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik gjenden në dosjen e mbajtur nga Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël. Anëtarët e Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël, si dhe antarët e Komisioneve të Prokurimit gjatë periudhës 2016-2019, 2020, 2021, kanë vepruar në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi dhe me angazhim të plotë në realizimin e detyrave të tyre.*

20.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit për kontratat e punimeve që do të lidhë në vijim t'i kërkojë mbikëqyrësve dhe operatorëve ekonomikë të kontraktuar plotësimin e dosjes me dokumentacionin teknik ligjor të munguar, që vërteton cilësinë e materialeve të vendosura në objekt, në të kundërt kundrejt kontraktorit, të aplikohen masa penalizuese sipas përcaktimeve ligjore e kontraktuale.

*Koment: **Në proces.** Rekomandimi do të mbahet parasysh nga AKB, por deri në këto momente nuk kemi patur kontrata të kësaj natyre. Ndërkohë theksojmë përsëri se dije se dokumentacioni gjëndet në dosjet e zbatimit të punimeve për secilin projekt.*

21.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa, t'aj dërgojë Bashkisë Tepelenë dokumentacionin përkatës të investimit të kryer në objektet òRijetëzimi i Qendrës së Fshatit Nivicë dhe òRikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë, duke i kërkuar kontabilizimin e vlerës së investimit të kryer, si dhe t'i kërkojë që të aplikojë pranë Drejtorisë Vendore të Kadastrës Tepelenë, për të bërë rivlerësimin e objekteve ndërtesa në pronësi òshtetë, sipas vlerës së marrë nga investimi i kryer, përkatësisht: Qendra e Fshatit Nivicë në vlerën 38,661,024 lekë (me TVSH) dhe shkolla e Vjetër Nivicë në vlerën 4,753,284 lekë.

*Koment: **Në proces.** Ky rekomandim, do të zbatohet përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022, pasi për shkak të angazhimeve institucionale, ka qenë i pamundur të ndiqej. Ndaj kërkojmë mirëkuptimin e organit të KLSH për të mundësuar një shtyrje të këtij rekomandimi. AKB do të njoftojë në vijim KLSH-n mbi ecurinë e këtij procesi.*

22.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që, për aplikimet në projektet IPA, të informojë paraprakisht Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të IPA II dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

Zyrarët Kombëtar Autorizues, duke marrë parapakisht miratimin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si organ epror për projektet potenciale ku synon të aplikojë.

Koment: Në proces për shkak se nuk kemi patur projekte të reja nga momenti i auditimit. Ky rekomandim vijon të mbahet parasysh nga AKB, ndërkohë që theksojmë përsëri se gjatë procesit të Auditimit, projektet ishin në fazë zbatimi dhe përqindja e përthithjes së fondeve duhet analizuar në përfundim të projektit. Aktualisht përqindja e përthithjes së fondeve është rritur dhe po vijohet me procesin e certifikimeve nga ana e zyrës së FLC. Përsa i përket konstatimit që mos shpenzimi i fondeve ka të bëjë me mungesën e kapaciteteve njerëzore të AKB dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm, kjo nuk ka lidhje me përthithjen e buxhetit të projektit. Kontraktimi i ekspertizave të jashtme, është bërë në zërin e buxhetit për ekspertizë të jashtme të projektit. Ky shpenzim nuk mund të bëhet në linjën e staff cost. Gjatë planifikimit të buxhetit në fazën e garimit hartohen dhe ndahen të gjitha buxhetet dhe aktivitetet sipas kërkesave të programit. Rishpërndarja e buxheteve, ndryshimi i aktiviteteve dhe spostimi i të gjithë afateve bëhet sipas rregullave të çdo programi specifik të cilat janë të përcaktuara në Manualin e Programit. Për të kuptuar në mënyrë të drejtë funksionimin e këtyre programeve përpara se të shprehemi për vonesat duhet të kuptojmë këto procedura të shprehura në manual. Siç është parashikuar që në hartimin e projektit, zëri i ekspertizës së jashtme është pikërisht për këtë qëllim. Pasi ka disa aktivitete specifike në projekt, që jo detyrimisht AKB duhet të ketë stafin përkatës, pasi bëhet fjalë për një periudhë kontraktimi që zgjat gjatë zbatimit të një projekti, dhe mbaron me zbatimin e projektit. AKB nuk mund të vendosë për ndarjen e detyrave dhe aktiviteteve, por duhet të përmbahet Fishës së miratuar të projektit. Nëse Autoriteti Menaxhues e ka miratuar kryerjen e një detyre si kontratë të jashtme, AKB nuk mund ta ndryshojë dhe ta realizojë me staf të brendshëm. Në rast se nuk mund ta kryejë se jashtëm atëherë AKB si përfitues duhet të drejtohet Sekretariatit Teknik të programit dhe të kërkojë ndryshimet në Fishën e Projektit, e cila me pas duhet të miratohet me votë dhe nga niveli më i lartë i Programit JMC.

23.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të parashikojë në programin buxhetor afatmesëm fondet përkatëse për projektet IPA si dhe të planifikojë për çdo vit, projektet potenciale IPA ku synon të aplikojë, për të cilën të marrë miratimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si organin epror dhe të rakordojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të përshpejtuar procesin e hapjes së kodit të investimit të projektit (FIF), me qëllim shmangien e vonesave të cilat kanë ndikuar në uljen e nivelit të përthithjes së fondeve IPA.

Koment: Në proces. Ky rekomandim do të mbahet parasysh nga AKB, ndërkohë që hapat e evidentuara gjatë auditimit janë ndjekur nga AKB. Në rastin e AKB në mungesë të një alokimi në buxhetin vjetor është gjetur zgjidhje e mbulimit të kësaj kuote nëpërmjet punës së stafit të përthithshëm. E thënë ndryshe pjesë e kostos së stafit të AKB i ngarkohen Projektit në përputhje me përqindjen e angazhimit të çdo pjesëtari të stafit. AKB ka konkurruar në shumë projekte, por është shpallur fitues vetëm në këto 4 projekte të përmendura. Kur konkurrohet në projekte të cilat nuk janë të paracaktuara, institucioni e ka të pamundur, të ketë një plan të buxhetit të detajuar, pasi dhe probabiliteti i fitimit të projektit është shumë i ulët.

24.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për çdo njoftim kontrate, të marrë masa për ta botuar shpalljen e kontratës, si dhe në të gjitha rastet kur duhet të ndjekë procedurën e thjeshtuar (simplified) të hartojë një raport mbi studimin e tregut për kandidatët e përzgjedhur dhe të shoqërojë me arsyet e përzgjedhjes së tyre, sipas rekomandimeve të dokumenteve standarde të PRAG-ut.

Koment: Në proces. Rekomandimi do të mbahet parasysh nga AKB, ndërkohë që theksojmë përsëri se: Varianti PRAG i përdorur në këtë kontratë, është i PRAG 2018.0, i cili ka qenë në fuqi deri në 15 Korrik 2019, pasi shpallja e kontratës është bërë në Janar 2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

25.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për çdo rast për kontrata të llojit òglobal priceò të përcaktojë në mënyrë të qartë në termat e referencës çfarë produktesh duhet të ofrojë operatori fitues, duke bërë shpërndarjen e kësteve të pagesave, sipas përcaktimeve të dokumentit standard òKontrataò të PRAG-ut, brenda afateve dhe formateve të caktuara me indikatorë të matshëm.

*Koment: **Në proces.** Ky rekomandim, do të mbahet parasysht nga AKB në vijim.*

26.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, gjatë hartimit të specifikime teknike, tòi formulojë kriteret kualifikuese në mënyrë të atillë që të zgjerojë rrethin e ofertuesve dhe jo duke përcaktuar kriteret kufizuese, por të marrë në konsideratë kërkesat minimale që ofron tregu shqiptar i ekspertëve mjedisorë.

*Koment: **Në proces.** Ky rekomandim do të mbahet parasysht nga AKB. Për rastin konkret, veçantia e llojit të punës që do të kryhej kërkon që eksperti të jetë me eskperience, siç quhet në këtë rast në çdo thirrje për ekspert, senior expert, pra me të paktën 10 vjet eskperience pune sipas çdo thirrje për ekspert. 10 vjet punë në fushën mjedisorë nuk kufizon, pasi ky është një nivel shumë i pranueshëm për llojin e ekspertizës. Për të patur një nivel sa më të kënaqshëm të studimit komisioni i hartimit të TOR-save grupi i punës ka menduar që ky kriter është ndihmues në rritjen e cilësisë dhe nuk ndikon në kufizimin e mundësisë së aplikimit të kandidatëve që nuk e përmbushin, pasi kujtojmë se në një garë konkurrohet me disa elementë dhe jo vetëm me vjetërsinë në punë. Në lidhje me ftesat, ato u janë dërguar personave me eskperiençë dhe të mirënjohur në këtë fushë. Nuk është apriori kualifikimi i tyre dhe gjithashtu në këtë rast nuk kërkohet "ekspert ideal". Vendosja e kriterit të paktën 10 vjet, për llojin e punës së kërkuar është shumë korrekte.*

27.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit, gjatë hartimit të referencave, të veçojë kriteret kualifikuese për personat juridikë dhe personat fizikë. Në rast kur përcakton vetëm për persona juridikë, të përcaktojë qartë numrin e ekspertëve të kërkuar dhe kualifikimin për secilin.

*Koment: **Në proces.** Ky rekomandim do të mbahet parasysht nga AKB.*

28.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të refuzojë ata ekspertë nga procedura tenderuese në rastet kur janë shpallur fitues për një kontratë tjetër, afati i zbatimit të të cilit është i njëkohshëm me kontratën e parë që është shpallur fitues.

*Koment: **Në proces.** Ky rekomandim do të mbahet parasysht nga AKB, bazuar dhe në Manualin e Prag.*

29.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë në analizë procedurën e tenderit me objekt òVlerësimi shëndetësor i stacioneve monitorueseò dhe të nxjerri përgjegjësit e personave përkatës, për mënyrën e zgjedhjes së llojit të procedurës së tenderimit.

*Koment: **Zbatuar.** Në lidhje me këtë rekomandim, Ju bëjmë me dije se procedurat janë realizuar sipas PRAG dhe se AKB disponon studimin me titull: "Mbledhja e të dhënave mbi breshkat e detit në zonën bregdetare jugore", përmes vlerësimeve dhe matjeve, ku ndër rezultatet kryesore synohet identifikimi dhe përshkrimi i zonave më potenciale të folezimit të breshkës Carreta carreta, e cila do të shërbejë si bazë për implementimin e kontratës së shërbimit me titull: "Vlerësimi shëndetësor i stacioneve monitoruese". Për sa më sipër zonat e identifikuara të folezimit të breshkës Carreta carreta janë si më poshtë vijon:*

- 1. Plazhi i Livadhit (Apelistr);**
- 2. Plazhi i Bunecit;**
- 3. Plazhi i Lukovës;**
- 4. Pema e Thatë (pjesa jugore).**

Bazuar në statutin e OJF òShoqata Shqiptare e Marketingutò, sjellim në vëmendje se fokusi kryesor i saj është në marketing, por fusha e veprimit është gjithpërfshirëse, si në kulturë, art, mjedis etj., sipas CV bashkëngjitur ofertës së dërguar. Duke qenë se Shoqata ka garuar me ekspertin kyç i cili i përmbush plotësisht kërkesa e paraqitura në Termat e referencës dhe duke



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

qenë se Shoqata kishte dhe vlerën më të ulët financiare e vlerësojmë si të saktë shpalljen e saj fituese.

Koment i subjektit: Përmes observacionit përcjellë me e-mail datë 09.05.2022, nga AKB është përcjellë sqarimi se Përsa i përket gjetjeve se në procedurën e prokurimit të kontratës së shërbimit me objekt “Vlerësimi shëndetësori stacioneve monitoruese” me vlerë 3,500 euro, procedura e thjeshtuar tenderuese nuk është zbatuar në përputhje me rregullat, Ju informojmë se rekomandimi i KLSH-s është zbatuar nga AKB. Për këtë pjesë punonjësi Emirjan Hate (pjesë e grupit të punës për projektin), i është nënshtruar dhe procedurës disiplinore dhe sqarimet e tij, i ka paraqitur dhe para Komisionit Disiplinor.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni do të merret në konsideratë.

30.1 Rekomandim: AKB të ri kërkojë pranë MTM vazhdimin dhe ecurinë e plotësimit të kësaj strukture me synim, realizimin final të përmbushjes së procedurave të inspektimit, për praktikën e ndodhura në proces ankimimi.

Koment: Ky rekomandim është **zbatuar**, përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 569, datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, është ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 17.03.2021 ku përcaktohet: Pas pikës 6, të Kreut III, të vendimit nr. 569, datë 17.07.2019 të Këshillit të Ministrave, shtohen pika 6/Ime këtë përmbajtje: Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit krijohet Komisioni i Ankimit të AKB-së, i cili drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe ka në përbërje të tij:

- a) Drejtuesin e njësisë përgjegjëse për performancën dhe menaxhimin e integruar të zonave bregdetare;
- b) Drejtuesin e njësisë përgjegjëse për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit të zonave bregdetare;
- c) Drejtuesin e njësisë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse;
- d) Nëpunësin përgjegjës për çështjet juridike/ligjore të agjencisë, në cilësinë e sekretarit të Komisionit të Ankimit të AKB-së.

Për sa më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i AKB-së ka ngritur Komisionin e Ankimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, me Urdhërin Nr. 16, datë 01.06.2021.

31.1 Rekomandim: AKB, strukturat përkatëse (DSZHQTZB, Sektori Juridik dhe Financës) të marrin masa për ndjekjen e hapave ligjor për arkëtimin e gjobave të vendosura nga inspektimet gjatë vitit 2020 ndaj subjekteve me veprimtari në kundërshtim me ligjin.

Koment: **Zbatuar**. Me ngritjen e Komisionit Ankimor sipas VKM nr.569/2019, janë shqyrtuar 18 ankime administrative, nga të cilat 14 ankime i përkasin 2020.

32.1.Rekomandim: AKB të marrë masa duke ri kërkuar tek bashkitë që nuk kanë kthyer përgjigje për njoftimet në lidhje me subjektet që janë identifikuar në mosplotësim të kriterëve ligjore për ushtrimin e aktivitetit stacion plazhi dhe mosplotësim të marrjes së masave anti COVID , si dhe duke i përfshirë në programet e inspektimeve dhe monitorimeve sipas shkallës së riskut në programet përkatëse periodike; me synim mbështetjen e subjekteve me veprimtari turistike në drejtim të përmirësimit të standardeve dhe shërbimit turistik dhe rritjen e shkallës së bashkëpunimit me NJVV-të dhe Organet e tjera.

Koment: **I zbatuar**. Ky rekomandim është mbajtur parasysh nga AKB, në vijimësi, me vazhdimin e procesit të monitorimeve, si dhe përfshirjen e inspektimeve të stacioneve të plazhit në programin vjetor të punës për vitin 2022, për të cilin është marrë miratimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe është informuar Inspektorati Qendror me shkresën e AKB-së Nr. 1973, datë 15.10.2021. Ky rekomandim është zbatuar plotësisht dhe vijon të zbatohet nga AKB, duke vënë në dijeni njësitë vendore dhe çdo institucion kompetente për problematikat dhe shkeljet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

evidentuara. Në kuadër të sezonit turistik veror 2020, 2021, 2022, hapja e sezonit turistik, dokumentacioni, procedura e miratimit, monitorimi për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, realizohet në përputhje me VKM-në Nr. 171 datë 27.03.2019 “Për miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, ku si autoritet i shqyrtimit të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi është ngritur Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (“GTSHA”).

33.1 Rekomandim: AKB të ndjekë monitorimet duke i përfshirë në planet përkatëse monitorim inspektiv, të raportoje ne Ministri dhe të bashkëpunojë me strukturat e tjera si NJVV-të për identifikimin dhe formalizimin e pajisjes me certifikatë të subjekteve, strukturave akomoduese ekzistuese dhe te reja që krijohen rishtas.

Koment: Ky rekomandim është zbatuar plotësisht nga AKB, në vijimsi, me vazhdimin e procesit të monitorimeve, si dhe përfshirjen e inspektiveve të strukturave akomoduese në programin vjetor të punës për vitin 2022, për të cilin është marrë miratimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe është informuar Inspektoriati Qëndror me shkresën e AKB-së Nr. 1973, datë 15.10.2021.

2.4.Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1.1.Rekomandim: AKB Tiranë, sektori i financës të marrë masat ligjore për arkëtimin e vlerës **48,325 lekë**, përfituar padrejtësisht nga punonjës dhe subjekte, si shpenzime të kryera nëpërmjet bankës në vitin 2020, pa mbështetje ligjore dhe të pa justifikuar me dokumente, konkretisht:

- vlera **2,000 lekë**, për gjobë tejkallim afati të kontrollit teknik të automjeteve me targa AA763NY dhe AA590PK nga drejtuesit e mjeteve me nga 1,000 lekë/secili.

- Në lidhje me këtë rekomandim, theksojmë se: Vlera 2.000 lekë, për gjobë tejkallim afati të kontrollit teknik të automjeteve me targa AA763NY dhe AA590 PK, nga drejtuesit e mjeteve me nga 1 000 lekë secili, **për të cilën AKB thekson se nuk ka qenë neglizhencë nga ana e personave përgjegjës vonesa e kolaudimit të automjeteve, por për shkak së procesi i pagesave nga ana e institucioneve ishte i bllokuar sipas Udhëzimit të Posaçëm të Ministrisë së Financave Nr. 441, datë 30.12.2019 “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, të cilat janë pjesë e dosjes së urdhërshpenzimit dhe me vulën e thesarit, dokumentacion provues I cili I është vënë në dispozicion grupit të auditimit.**

- vlera **24,960 lekë TVSH**, nga subjekti òB.C.ò shpk, pasi fatura e subjektit nr. 6, datë 03.08.2020 është e parregullt dhe jo e modelit tatimor, sepse subjekti është person juridik dhe jo person fizik, çka ka krijuar evazion fiskal, sipas urdhër shpenzimit nr. 212, datë 11.08.2020, shpenzime siguracioni TPL për 6 automjetet e institucionit.

*Koment: **I zbatuar**, në aspektin se nga ana e AKB janë marrë masa në mënyrë shkresore për arkëtimin e vlerës, Për vlerën 24,960 lekë subjekti X është i përjashtuar nga TVSH Konkretisht. Me shkresën Nr. 1978/4, datë 15.11.2021, me lëndë “Vënie në dijeni mbi Raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara”, AKB, ka njoftuar operatorin “B.C” sh.p.k, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH, në raportin përfundimtar, të dërguara në AKB me shkresën Nr. 20/10, datë 29.07.2021.*

Në lidhje me pretendimet e shprehura nga ana e grupit të auditimit se fatura e subjektit òB.C.ò sh.p.k, nr.06, datë 03.08.2020 është faturë e thjeshtë në vend të faturës me TVSH të modelit tatimor, çka ka krijuar evazion fiskal për vlerën 24,960 lekë. Sqarojmë se sipas ligjit nr 83/2019 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 3 përcakton se fjalët faturë e thjeshtë tatimore apo kupon tatimorë zëvendësohen me fjalët faturë. Pra në interpretim të nenit të mësipërm qartësisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

shihet se subjektet mund të lëshojnë faturë të thjeshtë tatimore. Është i paqartë në këtë rast termi i përdorur në raport si Ëvazion fiskalë. Sqarojmë se sipas ligjit nr 92/2014 “Për tatimin mbi vleren e shtuar, në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 53/a përcakton se janë të përjashtuar nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme shërbimet e sigurimit dhe të risigurimit, përfshirë kryerjen e shërbimeve të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime nga agjentët dhe brokerat e sigurimit. Pretendimi i ngritur nga grupi auditues bie ndesh me këtë ligj. Pra shuma me vlerë 24,960 lekë është e përfshirë në shumën totale të ofertës.

- vlera **21,365 lekë**, diferencë çmimesh për shpenzime mirëmbajtje printer zyrash, sipas urdhër shpenzimit nr. 342, datë 23.11.2020, nga komisioni i blerjeve vogla E.D, A.Z, G.T dhe financa M.T me nga 5,341 lekë/secili.

- Pjesa e vlerës prej 5.341 (pesëmijë e treqind e dyzet e një) lekë për punonjës, është shlyer nga punonjëset: A.Z, E.D, G.T, M.T, pranë degës së thesarit, nën kodin ËSekuestime e Zhdëmtimeë, në total 21.364 (Njëzet e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë. Bashkëngjitur dhë të dhënat nga thesari për këtë derdhje. Megjithatë, **në lidhje me këtë rekomandim, theksojmë përsëri se: AKB, në llogarinë e 602, nuk kishte fonde për investimet dhe duke qenë se blerja e materialeve të tilla përbën investim për institucionin, ka qenë e pamundur nxjerrja jashtë përdorimit e tyre dhe blerja e printerave të rinj.**

2.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **310,440 lekë**, nga operatori ekonomik “E.C.” sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rijetëzimi i Qendrës së Fshatit Nivicë”, Bashkia Tepelenë.

Koment: Zbatuar pjesërisht. Me shkresën Nr. 1978/3, datë 15.11.2021, me lëndë “Vënie në dijeni mbi Raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara”, AKB, ka njoftuar operatorin “E.C.” sh.p.k, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH, në raportin përfundimtar, të dërguara në AKB me shkresën Nr. 20/10, datë 29.07.2021. Operatorit “E.C.” sh.p.k i është dërguar informacion i detajuar, sipas raportit përfundimtar të mësipërm dhe i është kërkuar ndjekja e rekomandimit të KLSH-s dhe dërgimin e informacionit në AKB, lidhur me zbatimin e tij. Deri në këto momente nga ky operator nuk kemi përgjigje.

3.1. Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **595,300 lekë**, nga operatori ekonomik “C” sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë”, Bashkia Tepelenë.

Koment: Zbatuar pjesërisht. Me shkresën Nr. 1978/2, datë 15.11.2021, me lëndë “Vënie në dijeni mbi Raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara”, AKB, ka njoftuar operatorin “C” sh.p.k, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e KLSH, në raportin përfundimtar, të dërguara në AKB me shkresën Nr. 20/10, datë 29.07.2021. Operatorit “C” sh.p.k i është dërguar informacion i detajuar, sipas raportit përfundimtar të mësipërm dhe i është kërkuar ndjekja e rekomandimit të KLSH-s dhe dërgimin e informacionit në AKB, lidhur me zbatimin e tij. Deri në këto momente nga ky operator nuk kemi përgjigje.

4.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa e të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **330,200 lekë** nga operatori ekonomik “L.K” sh.p.k., paguar për situacionimin dhe përdorimin e fondit rezervë të pa argumentuar, në objektin “Sinjalistikë e Infrastrukturës turistike midis zonave bregdetare dhe malore”, vendosur në rrugën Borsh-Nivicë-Tepelene dhe rrugën Nivicë-Ura e Kardhiqit.

Koment: Zbatuar pjesërisht. Me shkresën Nr. 1978/1, datë 15.11.2021, me lëndë ËVënie në dijeni mbi Raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara, AKB, ka njoftuar operatorin ËL.Kë sh.p.k, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

KLSH, në raportin përfundimtar, të dërguara në AKB me shkresën Nr. 20/10, datë 29.07.2021. Operatorit òL.Kò sh.p.k i është dërguar informacion i detajuar, sipas raportit përfundimtar të mësipërm dhe i është kërkuar ndjekja e rekomandimit të KLSH-s dhe dërgimin e informacionit në AKB, lidhur me zbatimin e tij. Me shkresën Nr. 1374 prot, datë 19.11.2021, protokolluar në AKB me nr. 1978/5, datë 22.11.2021, operatori òL.Kò sh.p.k, ka sqaruar se i qëndron observacioneve të paraqitura në:

- Observacion datë 24.06.2020, të mbikëqyrësit të punimeve G&L, drejtuar KLSH dhe AKB.
- Observacion datë 30.07.2020, të sipërmarrësit të punimeve, drejtuar KLSH dhe AKB.
- Observacion datë 01.06.2021, të sipërmarrësit të punimeve, drejtuar KLSH dhe AKB.

2.5.Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1.1. Rekomandim: Titullari i AK të AKB nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për punime civile/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 1,474,273 leke, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

*Koment: **Në proces.** Në lidhje me rekomandimin 1.1, AKB i qëndron sqarimeve të mëparshme, të dhëna nëpërmjet KVO-s, ku përfaqësueset e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i qëndrojnë sqarimeve se: Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në prokurimin, objekti i të cilit është përmendur më lart, garantojmë se kemi punuar me përgjegjshmëri dhe përkushtim maksimal, (marrë parasysh edhe volumin e madh të dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit), në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore referuar prokurimeve publike. Vlerësimi i ofertave është bërë duke përbushur objektivin dhe qëllimin kryesor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Në vlerësim i jemi përbajtur në mënyrë strikte dokumenteve standarde të prokurimit me objekt “Rijetëzimi i qendrës së fshatit Nivicë” të cilat ishin përgatitur konform rregullave të përgjithshme të prokurimit të përcaktuara në kreun III të ligjit nr. 9643 dhe VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Kualifikimi i ofertuesve është bërë në zbatim të të gjitha pikave të nenit 46 të këtij ligji dhe për rastin e skualifikimit të shoqërisë “M” sh.p.k mund të veçojmë pikën 1 të këtij neni, shkronja b ku përcaktohet:*

1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat standarte kërkoheshin autobetonjere copë 2(dy), dhe nuk ishte përcaktuar asnjë alternativë tjetër. Mbi këtë kriter, nisur dhe nga procedura e prokurimit që kishte të bënte me punime ndërtimi, mungesa e një autobetonjere nuk mund të përbënte devijim të vogël dhe të merrej parasysh për kualifikimin e ofertuesit, në rastin konkret shoqëria “M” shpk. Kualifikimi i këtij ofertuesi do të penalizonte ofertuesin fitues, i cili i plotësonte të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat standarte dhe do të shkelej parimi i barazisë në konkurim midis ofertuesve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREDGETIT

Me të njëjtën mënyrë trajtohet edhe mosparaqitja nga ana e ofertuesit “M” shpk. E diplomës së Arkitektit, pasi diploma është dokumenti bazë që tregon aftësitë profesionale të personit, i cili në rastin konkret do të merrej me pjesën arkitekturore të objekteve të qëndrës së fshatit Nivicë.

2.1. Rekomandim: Titullari i AK të AKB nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **923,791 leke**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Koment. Në proces.

2.6.Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër Inspektimin e Ndërtimitò, ndryshuar me Ligjin Nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të Bashkisë Tepelenë të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë në masën **50,000 lekë për:**

- **Z. V.B.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, drejtues ligjor dhe teknik i shoqërisë òN.Gö SHPK, ndryshuar emri në òN.Gö SHPK dhe licencë MK. 3101/1, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për Kontratën e zbatimit me Nr. Prot. 604/6, datë 26.12.2017, me objekt: “Rikonstruksion i ish Shkollës së vjetër Nivicë”, Bashkia Tepelenë, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik ò Cö SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 595,300 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Koment: Në proces.

F. MASA DISIPLINORE:

I. Mbështetur në nenin 58 òLlojet e masave disiplinoreò të ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin civilò, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 òPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, i rekomandojmë titullarit të institucionit, në varësi të analizës së përgjegjësisë, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të trajtuar në Raportin Përfundimtar për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara për dhënien e masave disiplinore, si dhe:

1.T i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik(APP) për dhënien e masave disiplinore nga òVërejtjeò deri òLargim nga shërbimi civilò, për punonjësit e cituar më poshtë, duke e zgjeruar dhe për punonjës të tjerë sipas gjykimit dhe vlerësimit të titullarit, si vijon:

Nga 11 masa disiplinore, janë zbatuar 7 masa disiplinore, për 3 punonjës janë ezuruar për shkak se janë larguar ndërsa 1 nuk është zbatuar.

Në lidhje me masat disiplinore të propozuara për punonjësit:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREGDETIT

1. Për znj. K.T, me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së, Nr. 81, datë 22.11.2021, për Krijimin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kombëtare e Bregdetit, ka filluar procesin disiplinor ndaj punonjësës në fjalë.
2. Për z. E.H, me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së, Nr. 77, datë 22.11.2021, për Krijimin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kombëtare e Bregdetit, ka filluar procesin disiplinor ndaj punonjësit në fjalë.
3. Për znj. E.D, me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së, Nr. 78, datë 22.11.2021, për Krijimin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kombëtare e Bregdetit, ka filluar procesin disiplinor ndaj punonjësës në fjalë.
4. Për znj. A.Z, me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së, Nr. 79, datë 22.11.2021, për Krijimin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kombëtare e Bregdetit, ka filluar procesin disiplinor ndaj punonjësës në fjalë.
5. Për znj. G.T, me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së, Nr. 75, datë 22.11.2021, për Krijimin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kombëtare e Bregdetit, ka filluar procesin disiplinor ndaj punonjësës në fjalë.
6. Për z. B.C, me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së, Nr. 76, datë 22.11.2021, për Krijimin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kombëtare e Bregdetit, ka filluar procesin disiplinor ndaj punonjësit në fjalë.
7. Për znj. B.K, me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së, Nr. 76, datë 22.11.2021, për Krijimin e Komisionit Disiplinor të Agjencisë Kombëtare e Bregdetit, ka filluar procesin disiplinor ndaj punonjësit në fjalë.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit paraqet një nivel të lartë të zbatimit të rekomandimeve dhe janë marrë masa nga titullari i institucionit, përmes urdhrave dhe ngritjes së grupeve të punës për zbatimin e tyre dhe nuk rezultojnë të ketë masa të pazbatuara, për të cilat do të mund të rikërkohej zbatimi i tyre.

V. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT

1. Akt-konstatimi nr. 1 datë 18.03.2022 mbajtur në AKB.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT